



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

nr. 119 vet. 16 dt. 18.06.2015 Për Jurinë e FFTK te Valles Popullore Burimore ne Lushnje.

Neni 3

Kohëzgjatja

Efektet juridike të kësaj kontrate fillojnë që nga dita e nënshkrimit të kontratës, deri në përmbushjen e plote të detyrimeve.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e QKVT

Në kuadër të kësaj kontrate QKVT ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

1. “QKVT” ka të drejtë të kërkojë nga “Antarët e Jurisë” përmbushjen në kohë dhe me cilësi të objektit të kësaj kontrate.
2. “QKVT” ka detyrimin të vërë në dispozicion të “antarëve të jurisë”, pa pengesa, programet e cdo grupi pjesëmarrës në Festival.
3. “QKVT” ka detyrimin të paguajë “antarët e jurisë” sipas parashikimit të bërë në kontratë.
4. “QKVT” merr përsipër të sigurojë akomodimin e ushqimin e antarëve të jurisë te FFTK, i siguron “antarëve të jurisë” udhëtimin Tiranë -Lushnje-Tiranë etj.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Antarëve të Jurisë

Në kuadër të kësaj kontrate “Antarët e jurisë” kanë të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

Adresa: Rr.“Gëzim Erebara” pranë pallatit nr.31 TIRANE, Shqipëri,

Tel.04 225 45 80

Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje midis palëve nënshkruese të kontratës do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre, në rast të kundërt palët do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë pas ezaurimit të ankimit administrativ, pranë Ministrit Kulturës.

Neni 11

Dispozita të fundit

1. Çdo korrespondencë që palët do të drejtojnë njëri tjetrit do të bëhet në të gjitha format e komunikimit të parashikuara dhe të shpejta (postë elektronike) përveç rasteve kur forma zyrtare/protokollare rezultojnë e pazëvendësueshme;
2. Për rastin e korrespondencave të QKVT ato do të dërgohen në adresën që do të komunikohet nga "Antaret e Jurise", ndërsa në rastin e kundërt ky do të dorëzojë në (3) shkresat në tre kopje pranë zyrës së protokollit, një për Zyrën e Financës një për Drejtorinë që mbulon fushën përkatëse dhe një për zyrën e protokollit.
3. Çdo aspekt tjetër i paparashikuar në këtë kontratë do të rregullohet në bazë të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. "Antaret e Jurise", gjatë kohës së Kontratës si edhe dy vjet pas mbarimit të saj, nuk duhet të zbulojë asnjë informacion në lidhje me shërbimin, kontratën apo veprimtarinë e "QKVT" pa marrë më parë leje të shkruar nga ana e "QKVT".
5. Çdo ndryshim i neneve të kësaj kontrate bëhet me miratim të dy palëve.

Adresa: Rr. "Gëzim Erebara" pranë pallatit nr.31 TIRANE, Shqipëri,
Tel.04 225 45 80
Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

Nr. 120 / 2 prot

Tiranë, më 19.06.2025

KONTRATË

E lidhur sot më dt. 19.06.25 midis palëve kontraktuese:

Qëndrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale me qendër në Tiranë, Përfaqësuar nga z.Nikolin Kotherja Titullar i QKVF-se, Rruga Gezim Erebara, Tirane, Shqiperi këtë e tutje **"QKVT"**.

Dhe

z. Leonard Syziri anetar i Jurisë së FFKT të Valles Popullore Burimore ne Lushnje dt 23-25.06.2025, këtë e tutje "Anëtar Jurie". bashkëlidhur karta e identitetit.

Neni 1

Objekti i kontratës së shërbimit

Objekti i kësaj kontrate është pagesa dhe angazhimi i antarëve të Jurisë për një periudhë 2 ditore në kuadrin e Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Valles Popullore Burimore. (këtë e tutje Festivali). Ky Festival do të zhvillohet në datat 23-24.06.2025

Neni 2

Baza ligjore

Kontrata hartohet në bazë të dispozitave ligjore të parashikuara nga nenet 850 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, si dhe në mbështetje të nenit 26 dhe 27 të Ligjit nr. 10 352, dt. 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", i ndryshuar ligjin nr. 27/2018, Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, Urdhërin e QKVT-se

Adresa: Rr. "Gëzim Erebara" pranë pallatit nr.31 TIRANE, Shqipëri,
Tel.04 225 45 80

Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

Neni 8

Forca Madhore

1. Palët nuk mbajnë përgjegjësi në rast të shkaktimit të një force madhore, që mund të jetë një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, vendime të Qeverisë, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë . Palet kontraktuese të përmbushin detyrimet perkatese sipas kesaj Kontrate, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të Palëve dhe nuk ndodhin për faj të tyre dhe kur Palët nuk jane në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse kane ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tyre.
2. Defektet në paisjet ose materialet ose vonesat per ti bërë ato të disponueshme, konfliktet e punës, grevat ose problemet financiare nuk mund të kërkohet të konsiderohen nga Palët si Forcë Madhore, përvec rastit kur burojnë nga një rrethanë e lidhur me Forcën Madhore.

Neni 9

Detyrime të përbashkëta

1. Palët kanë detyrimin të sillen me korrektësi dhe paanësi kundrejt njëra-tjetrës brenda kushteve të arsyeshme.
2. Kjo nënkupton, përveç të tjerave që palët gjatë përmbushjes së detyrimeve kontraktore dhe ushtrimit të aktivitetit të tyre ekonomik kujdesen të mos cenojnë njëra-tjetrën në lidhje me imazhin apo emrin e mirë, si dhe te drejtat e tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh dhe konventat ndërkombëtare në këtë fushë, ku shteti shqiptar është palë.

Adresa: Rr. "Gëzim Erebara" pranë pallatit nr.31 TIRANE, Shqipëri.
Tel.04 225 45 80
Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

1. Të vlerësojnë me korrektësi performancat e grupeve pjesmarrese ne festival gjatë 2 (dy) netëve të festivalit.
2. Të vlerësojnë dhe të mbajnë dokumentacionin përkatës për shpalljen e çmimeve fituese.
3. Të bashkëpunojnë me të gjithë antarët e jurisë.
4. Të ruajnë marrdhëniet e bashkëpunimit midis kolegëve dhe të mirëpresë sugjerimet e tyre në lidhje me punën.

Neni 6

Çmimi dhe modalitetet e Pagesës

1. Çmimi total i kontratës që do të paguhet nga ana e QKVT sipas përcaktimeve të bëra në këtë kontrate do të jetë në vlerën totale prej **24.000 Lekë**, përfshirë komisionet bankare dhe të gjitha detyrimet fiskale që njeh legjislacioni shqiptar.
2. Vlera e Kontratës e përmendur në pikën 1 të këtij neni, do të paguhet në llogarinë bankare bashkalidhur kesaj kontrate.

(llogari personale)

Iban:

Neni 7

Kushte penale vlerësuese

Mungesa e dorëzimit të dokumentacionit të parashikuar nenin 6 pika 2 të kësaj kontrate, në formën dhe kohën e parashikuar e në çdo rast jo më vonë se data 15 e muajit dhjetor të vitit financiar 2025 shkakton humbjen e të drejtës për tu paguar për detyrimin në kuadër të kësaj kontrate.

Adresa: Rr. "Gëzim Erebara" pranë pallatit nr.31 TIRANE, Shqipëri,
Tel.04 225 45 80
Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al